



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 8 të Udhëzimit administrativ, nr. 01/2015, për transparencë në komuna, nenit 32 pika c dhe nenit 34 paragrafi 34.1 shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më **31.10.2018**, merr këtë

**V E N D I M**  
**PËR KONSULTA PARAPRAKE PUBLIKE**

**I.**

Miratohet Vendimi për dërgimin e Rregullores për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në komunën e Prishtinës, në konsulta paraprake publike.

**II.**

Komisioni lidhur me vendimin e cekur në pikën I, do të ofrojë informata të nevojshme për opinionin-qytetarët e interesuar, përmes formave të fushatave informative, kontakteve me grupe të interesit dhe palët e interesuara për t'i diskutuar propozimet.

**III.**

Konsultat paraprake publike për rregulloren e cekur në pikën I të këtij vendimi, do të zgjasin 15 ditë.

**IV.**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen, Kryetari i Komunës dhe njësitë përgjegjëse.

**V.**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**01-183/02-263796/18, më 01.11.2018**

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Agim Kuleta**

